

MARRËVESHJE

NË MES TË

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

PËR BASHKËPUNIM POLICOR

PREAMBULA

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, këtu e tutje të referuar si "Palët",

Në kuadër të aspiratave të tyre për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale në frymën e miqësisë ekzistuese dhe të bashkëpunimit në mes të dy vendeve,

Duke marr parasysh dëshirën e Palëve për të marr pjesë në mënyrë aktive në procesin e bashkëpunimit në Evropë,

Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e mbrojtjes së jetës, pronës dhe të drejtave dhe lirive tjera themelore të shtetasëve të tyre,

Duke identifikuar përparësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar si faktori më i rëndësishëm në parandalimin efikas dhe luftën kundër krimit të organizuar të terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore, drogave narkotike, substancave psikotropike dhe lëndëve të para, krimit ndër-kufitar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme,

Duke marr parasysh dispozitat e konventave dhe traktateve ndërkombëtare në këtë fushë, në të cilat Republikat e Palëve janë pjesëmarrëse,

Janë dakorduar në mënyrë të kjarhtë (këtu e tutje referohet si "Marrëveshja") si në vijim:

Neni 1

FUSHA E VEPRIMIT

Në përputhje me dispozitat e legjislacionit të tyre kombëtar, organet kompetente të Palëve do të bashkëpunojnë me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të akteve kriminale në fushat në vijim, mirëpo nuk kufizohen në:

1.1 Prodhimin e paligjshëm, eksportimin, importimin, transportimin e paligjshëm, trafikimin e paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe lëndëve të para;

1.2 Luftën kundër terrorizmit dhe formave serioze të krimit të organizuar;

1.3 Krimin e organizuar, përfshirë trafikimin e paligjshëm të artit dhe kulturor, krimin ekonomik;

1.4 Prodhimin e paligjshëm, trafikimin në dhe posedimin me kemikale toksike, materialeve biologjike, radioaktive dhe nukleare, mallra dhe teknologji me rëndësi strategjike dhe teknikat ushtarake;

1.5 Trafikimin me njerëz, nxitjen e trafikimit me qëllim të eksploatimit seksual ose të ndonjë mënyre tjetër dhe ndërmjetësimit për prostitucion;

1.6 Mbrojtjen e dëshmitarëve;

1.7 Krimit ndër-kufitar, me theks të veçantë në luftimin kundër migrimit ilegal dhe akteve kriminale që ndërlidhen, por nuk kufizohen në:

1.7.1 Kalimin ilegal të kufirit shtetërorë;

1.7.2 Aktivitetet ilegale që ndërlidhen me kanalet e organizuara për trafikimin e genieve njerëzore dhe kontrabandimin e migrantëve;

1.7.3 Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, me identitet të vjedhur, dhe dokumenteve të udhëtimit jo valide dhe të tjera të ngjashme;

1.7.4 Transferimi ilegal përtej kufirit shtetëror, qëndrimin jo ligjor, mos respektimin e pasaportës dhe regjimit të vizave, falsifikimit dhe përdorimin e dokumenteve të udhëtimit dhe të vizave;

1.8 Vjedhjen dhe trafikimin ilegal të automjeteve motorike, falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara që lidhen me krimin e automjeteve;

1.9 Tregtimin e paligjshëm me mallra të akcizës dhe akteve të tjera kriminale që ndërlidhen me tregtinë ndërkombëtare dhe këmbimin ekonomik, evazionin tatimor, shpërlarjen e parave dhe të ardhurave të tjera të ndërlidhura të krimit(eve) të theksuara;

1.10 Prodhimin e paligjshëm, trafikimin dhe posedimin e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve; dhe

1.11 Aktiviteteve kriminale të ndërlidhura kibernetike.

## Neni 2

### PROTOKOLLET PËR IMPLEMENTIM

Në përputhje me këtë Marrëveshje, me synim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së bashkëpunimit në mes të Palëve, Palët mund të nënshkruajnë protokolle shtesë relevante për bashkëpunim në fusha specifike dhe për qëllimet e kësaj Marrëveshje.

## Neni 3

### AUTORITETET KOMPETENTE

Organet kompetente për implementim të kësaj Marrëveshje janë:

- 3.1 Ministria e Brendshme, Republika e Kosovës; dhe
- 3.2 Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Maqedonisë,

## Neni 4

### DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE ME DETYRIME LIGJORE

Gjatë implementimit të bashkëpunimit të parashtruar në Nenin 1 të kësaj Marrëveshje, organet kompetente të Palëve Kontraktuese në mënyrë specifike do të marrin parasysh dispozitat nga, mirëpo pa u kufizuar në:

- Protokollin që amandamenton Konventën Unike mbi Drogat Narkotike 1961, të datës 25 Mars 1972 -
- Konventën mbi Substancat Psikotropike të datës 21 Shkurt 1971,
- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotropike të datës 20 Dhjetor 1988;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional të datës 15 Nëntor 2000;
- Konventa për Mbrojtjen e Individëve sa i përket Procesimit Automatik të të Dhënave Personale të datës 28 Janar 1981;
- Protokollit shtesë të Konventës mbi Mbrojtjen e Individëve sa i përket Procesimit Automatik të të Dhënave Personale lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe rrjedhën trans-kufitare të të dhënave;
- Rekomandimit Nr. R (87) 15 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të datës 17 Shtator 1987 që rregullon shfrytëzimin e të dhënave personale në sektorin e policisë.

## Neni 5

## KUSHTET E BASHKËPUNIMIT DHE TË IMPLEMENTIMIT

Në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtarë të Palëve, organet kompetente të Palëve do të bashkëpunojnë përmes:

5.1 Shkëmbimit të informacioneve mbi aktet kriminale të cekura në Nenin 1 të Marrëveshjes, mbi të dyshuarit ose kriminelët, modus operandi, kohën, vendin dhe masat e ndërmarra për parandalimin e akteve kriminale ndaj autorëve të krimit dhe bashkëfajtorëve të tyre;

5.2 Shkëmbimin e informatave dhe të përvojës lidhur me paraqitjen e llojeve të reja të akteve kriminale;

5.3 Raportimit me kohë mbi operacionet ose veprimet e ardhshme në zonat kufitare;

5.4 Shkëmbimin e informacioneve lidhur me luftën kundër korrupsionit në mesin e personelit policor;

5.5 Shkëmbimin e informative mbi rreziqet eventuale të sigurisë në kufinjët e përbashkët të tillë si lëvizja e individëve ose grupeve të njerëzve në drejtim të apo në zonën kufitare;

5.6 Shkëmbimin e informatave dhe të dokumentacionit me informata shkencore dhe teknike të cilat nuk shkelin legjislacionin përkatës të vendeve;

5.7 Prezantimin reciprok të literaturës së specializuar sipas kërkesës, që nuk shkel legjislacionin përkatës të vendeve dhe/ose të drejtat intelektuale ose pronësorë;

5.8 Këmbimin reciprok të informacioneve lidhur me dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme si dhe amandamentet që kanë të bëjnë me lëndën e temës së Marrëveshjes.

5.9 Bashkëpunimi gjatë vëzhgimit të personave të dyshuar për kryerje të akteve kriminale dhe personave që i shmangen përgjegjësisë kriminale ose që vuajnë dënimin penal;

5.10 Bashkëpunimi gjatë kërkimit të personave të humbur edhe që nuk kanë të bëjnë edhe që kanë të bëjnë me aktet kriminale si dhe kryerjen e aktiviteteve që lidhen me identifikimin e personave;

5.11 Shkëmbimin e informative mbi rezultatet e hetimeve kriminale mbi aktet kriminale, teknikat e hetimit, aplikimin e metodave dhe burimeve me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të tyre, që nuk shkel legjislacionin përkatës të vendeve;

5.12 Shkëmbimin e produkteve analitike të hetimeve ndërkombëtare kriminale në luftën kundër krimit të organizuar që nuk shkel legjislacionin përkatës të vendeve dhe/ose të drejtat intelektuale ose pronësorë, dhe

5.13 Shkëmbimin e rezultateve nga ekspertizat kriminale të rasteve në fushën e krimin të organizuar, që nuk përfshijn shkelje të procedurave përkatëse kriminale të Palëve, shkelje të anonimitetit të personave të mbrojtur në mënyrë ligjore, ose çështje të ngjashme. Gjithashtu, kjo nuk duhet të shkel legjislacionin përkatës të vendeve dhe/ose të drejtat intelektuale ose pronësore.

## Neni 6

### KRIJIMI I KOMISIONIT TË PËRBASHKËT

Duke iu referuar implementimit të aranzhimeve të theksuara në këtë Marrëveshje, organet kompetente të Palëve do të krijojnë Komisionin e Përbashkët (Komisioni) në përbërje prej tre (3) anëtarëve nga secila Palë.

Komisioni do të takohet aq herë sa do të jetë e nevojshme, mirëpo së paku njëherë në vit kalendarik universal. Komisioni do të konsultohet mbi efikasitetin e kësaj Marrëveshje si dhe nëse ndryshimet ose plotësimet e mundshme janë të nevojshme për bashkëpunim të mëtejshëm. Takimet do të mbahen një herë në Republikën e Maqedonisë dhe një herë në Republikën e Kosovës. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Komisioni do të takohet sa më shpejt që të është e mundshme, mirëpo jo më vonë se sa ditët e mbetura të afuara të vitit kalendarik që jemi. Republika e Kosovës do të fillon si pala nikoqire e parë.

Sipas nevojës, Komisioni do të krijojë ekipe të përbashkëta pune për diskutimin e taktikave për adresimin e çështjeve që ngriten në vazhden e bashkëpunimit dhe do të vendosin se ku dhe si të veprojnë. Përfaqësues të institucioneve tjera të Palëve mund të marrin pjesë në takimet e Komisionit.

Komisioni mund të vendosë të krijojë grupe punuese shtesë. Bazë për krijimin e grupeve punuese mund të jetë, por nuk kufizohet:

6.1 Koordinimi taktik i aktiviteteve relevante për identifikimin e kanaleve për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e migrantëve; shkëmbimin e informative duke definuar format specifike të bashkëpunimit në praktikë dhe të aplikacioneve përkatëse.

6.2 Për temat që do të diskutohen nga grupet punuese, anëtarët e delegacioneve, kohën dhe agjendën e takimeve, do të dakordohen paraprakisht nga anëtarët e Komisionit.

6.3 Shpenzimet e akomodimit të grupeve punuese, përveç nëse dakordohen ndryshe, do të barten nga Pala nikoqire, përveç shpenzimeve të udhëtimit për në Republikën e Kosovës ose përkatësisht për në Republikën e Maqedonisë, dhe shpenzimet e kthimit.

Procesverbalet e takimeve dhe konkluzionet do të regjistrohen në protokollet e përpiluara në gjuhët e palëve dhe në gjuhën angleze nëse Komisioni e konstaton si të nevojshme. Komisioni do të përcaktojë se një përfaqësues prej anëtarëve nikoqir të Komisionit do të mbajnë procesverbalin dhe konkluzionet e takimit, duke ua dërguar të gjithë anëtarëve të komisionit një kopje të njëjtë sa më shpejt që është e mundshme në mënyrë të arsyeshme.

## Neni 7

### PËRDORIMI I GJUHËVE ZYRTARE

E gjithë korrespondenca me qëllim të Marrëveshjes do të bëhet në gjuhën(t) zyrtare të Palëve përkatëse dhe në gjuhën angleze, nëse është e nevojshme.

## Neni 8

### KUSHTET PËR SHKËMBIMIN E INFORMATAVE

Palët do të ndërmarrin masa adekuate për përmirësimin e komunikimit në mes të organeve kompetente përkatëse të tyre duke:

8.1 Emëruar persona kontaktues;

8.2 Organizuar takime të nivelit lokal, rajonal dhe qendror;

8.3 Shkëmbyer ekspertë afat-shkurtë, me kërkesë të organeve kompetente të Palëve, me synim të përmirësimit të shkëmbimit të informatave dhe të përvojës. Organet kompetente do të diskutojnë dhe të dakordohen me kushtet dhe metodën e pagesës përkatëse për secilën kërkesë që ka të bëjë me ekspertët afat-shkurtë ose ngjarjet relevante dhe sa i përket shpenzimeve për kërkesën e Palëve dhe nevojat e ndërlidhura; dhe

8.4 Ofruar reciprokisht informacione mbi informatat relevante të kontaktit, përfshirë, por jo duke u kufizuar në, numrat e telefonit dhe të faksit, adresa të postës elektronike, lidhjeve me radio dhe në përputhje me Nenin 5.

## Neni 9

### METODAT PËR BASHKËPUNIM

Palët do të ndërmarrin masa të arsyeshme dhe adekuate për përmirësimin e bashkëpunimit në mes të organeve përkatëse kompetente të tyre duke, por duke mos u kufizuar në:

9.1 Definuar strukturat për bashkëpunim në luftën kundër krimit;

9.2 ur është praktike, duke hapur zyra të përbashkëta;

9.3 Përgatitur analiza të përbashkëta mbi gjendjen dhe planet e veprimit për përmirësim të bashkëpunimit;

9.4 Zhvilluar akcione të koordinuara në mes të Palëve në pikat e përbashkëta kufitare tokësore dhe zonat kufitare të ndërlidhura; dhe

9.5 Patrollave të përbashkëta përgjatë kufinjëve tokësorë të përbashkët.

#### **Neni 10**

##### **TRAJNIMI I PËRBASHKËT**

Organet kompetente të Palëve do të bashkëpunojnë në fushën e trajnimit të stafit, posaqërisht, por duke mos u kufizuar në:

10.1 Shkëmbimin e përvojave dhe informatave në lidhje me metodologjitë që kanë të bëjnë me detektimin dhe hetimin e krimeve dhe shkeljeve të specifikuara në Nenin 1;

10.2 Organizuar seminare të përbashkëta dhe ngjarje të tjera trajnimi;

10.3 Trajnime të përbashkëta të ekspertëve në qendra përkatëse trajnuese të Palëve;  
dhe

10.4 Pjesëmarrja e vëzhguesve në lidhje me ushtrimet e ndërlidhura.

#### **Neni 11**

##### **KUSHTET E SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE**

Para fillimit të shkëmbimit të të dhënave personale, organet kompetente të Palëve do të përcaktojnë:

11.1 Kategoritë e të dhënave personale që do të transferohen;

11.2 Afatet e fundit për mbajtjen e të dhënave personale që janë transferuar;

11.3 Mënyrën e shkatërrimit dhe fshirjes së të dhënave personale, dhe

11.4 Procedurat në lidhje me respektimin e parimeve themelore për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **Neni 12**

##### **TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE**

Sa i përket transferimit dhe shkëmbimit të të dhënave personale të komunikuar në pajtim me këtë Marrëveshje, Republika e Kosovës do të përshtat dispozitat kombëtare të nevojshme në mënyrë që të arrijn nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale që është në përputhje me parimet e Rekomandimit Nr. R(87) 15 të datës 17 Shtator 1987 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që rregullon përdorimin e të dhënave personale në sektorin e policisë.

Republika e Kosovës duhet të arrijë nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale duke plotësuar standardet minimale siç janë theksuar në Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procesimin Automatik të të Dhënave Personale të datës 28 Janar 1981.

Komunikimi i të dhënave personale që sigurohet në këtë Marrëveshje nuk do të bëhet deri sa dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të specifikuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Nenin, nuk hyjnë në fuqi në Republikën e Kosovës.

Shkëmbimi reciprok i të dhënave personale në mes të organeve kompetente të Palëve, të specifikuar në Nenin 3 të kësaj Marrëveshje, do të bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve, duke respektuar kushtet të definuara nga organi që transferon të dhënat personale, si dhe në përputhje me kushtet dhe parimet për mbrojtjen e të dhënave personale:

12.1 Para transferimit të të dhënave personale, Palët do të sigurojnë të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative me qëllim të sigurimit të një niveli të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale që është lëndë transferimi;

12.2 Pa pëlqimin e organit dërgues, të dhënat personale që i nënshtrohen transferimit nuk do të përdoren për qëllime të tjera përveç atyre për të cilat është bërë transferimi;

12.3 Të dhënat e siguruar do të shkatërrohen ose korigjohen kur:

12.3.1 Dëshmohet se të dhënat janë të pavërteta; ose

12.3.2 Organi kompetent dërgues njofton se të dhënat janë mbledhur ose siguruar duke bërë shkelje të ligji; dhe/ose;

12.3.3 Të dhënat nuk janë më të nevojshme për implementimin e detyrës për të cilën të dhënat janë transferuar, përveç nëse ka leje eksplicite për përdorim të këtyre të dhënave për qëllime të tjera.

12.4 Me kërkesë të Palës transferuese, Pala pranuese do të siguron informacione lidhur me përdorimin e të dhënave të transferuara dhe rezultatet e arritura, përveç nëse kërkesa mund të cenon sigurinë kombëtare;

12.5 Pala transferuese ka për obligim të kontrollojë nëse të dhënat janë korrekte dhe transferimi është i nevojshëm dhe i duhur. Në qoftë se, pas transferimit, përcaktohet se të dhënat e transferuara janë të pavërteta ose se Pala dërguese nuk do të duhej të dërgonte të dhënat, Pala pranuese duhet menjëherë të informohet. Pala pranuese do të korigjoni të dhënat ose nëse të dhënat janë transferuar, do të shkatërrojë ose fshijë të dhënat e transferuara;

12.6 Pala pranuese është e obliguar të mbron në mënyrë efektive të dhënat personale nga qasja e paautorizuar ose ndryshimi ose zbulimi i paautorizuar;

12.7 Në rast të qasjes ose shpërndarjes së paautorizuar të të dhënave të ofruara, organi kompetent i Palës pranuese menjëherë do të informon organin dërgues lidhur me rrethanat



që kanë të bëjnë me qasjen ose shpërndarjen e paautorizuar, si dhe për veprimet e ndërmarra për hetimin e ngjarjeve. Përveç kësaj, veprimet e ndërmarra për rregullimin shkaljeve të ngjashme të ardhshme të ndërlydhura ose veprimet mund të diskutohen në takimin e Komisionit;

12.8 Palët janë të obliguara të mbajnë evidenca për të dhënat personale të dërguara, të pranuar dhe të fshira. Mënyra e mbajtjes së evidencës do të dakordohet nga Palët që së paku të përmban të dhënat dhe standardet në vijim:

12.8.1 Dokumenti që përdoret si shabllon i ngjashëm nga të dyja Palët do të përmban datën e kërkesës, kohën e kërkesës, mënyrën kërkesa është dërguar (formë të letrës, në mënyrë elektronike, telefonike, etj), emrin dhe mbiemrin, gradën, titullin dhe njësinë e personit që e bën kërkesën;

12.8.2 Dokumenti do të përmban faktet relevante lidhur me qëllimin e kërkesës, informacionit të kërkuar dhe mënyrën që informacioni duhet ti dërgohet Palës kërkuese dhe nëse është relevante nevojën për përshejtimin e kërkesës;

12.8.3 Dokumenti do të thekson trajtimin e të dhënave relevante sipas standardeve të dakorduara në mes të palëve (d.m.th. sekret konfidencial ose tepër sekret);

12.8.4 Mbajtja e evidencës së dërgimeve do të jetë dokument konfidencial i kontrolluar relevante për praktikën e mbajtjes së evidencave të materialeve të ndieshme të Palëve; dhe

12.8.5 Evidencat e dërgimit do të ruhen për një periudhë jo më të gjatë se sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në përputhje me periudhën e definuar nga Pala transferuese.

12.9 Gjatë transferimit të të dhënave personale, Pala dërguese do të njofton Palën kërkuese lidhur me periudhën e ruajtjes së të dhënave personale, që duhet të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit ose me ligjin ndërkombëtar të pranueshëm. Pavarësisht periudhës së ruajtjes, të dhënat personale nuk mund të ruhen më gjatë se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimet. Pala dërguese duhet të informohet për fshirjen e të dhënave që i janë nënshtruar transferimit dhe për arsyet e fshirjes së tyre. Në rast të përfundimit së kësaj Marrëveshje, të gjitha të dhënat që i janë nënshtruar transferimit duhet të shkatërrohen ose të fshihen, përveç nëse të dhënat e tilla janë relevante për Palët në procedurat gjyqësore ose mbahen si dëshmi për procedurë gjyqësore. Në raste të tilla, Pala pranuese duhet të informon Palën dërguese dhe të siguron se me lirim të të dhënave, sipas procedurave përkatëse gjyqësore dhe për dëshmi të Palës, të dhënat e theksuara do të shkatërrohen në përputhje me këtë Marrëveshje;

12.10 Personi të dhënat e të cilit janë ose do të transferohen, mund të kërkon të informohet rreth të dhënave personale që i transferohen dhe qëllimet e procesimit të tyre, nëse kështu lejohet me legjislacionin kombëtar të vendeve të Palëve dhe me ligjin ndërkombëtar të pranueshëm;

12.11 Palët obligojnë vetën që mos të dërgojnë të dhëna personale që transferohen në pajtim me këtë Marrëveshje organeve të tjera nga ato të theksuara në Nenin 3 të kësaj Marrëveshje, përveç me pëlqim me shkrim të Palës dërguese;

12.12 Transferimi i të dhënave personale mund të refuzohet kur ekziston ndonjë kërcënim ndal sigurisë kombëtare ose rendit publik;

12.13 Palët obligojnë vetën të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për t'iu shmangur dëmeve të shkaktuara nga persona të tretë si rezultat i transferimit, pranimi ose përdorimit të të dhënave dhe të eliminojnë shkaqet që mund të qojnë të pasoja të mundshme jo të favorshme; dhe

12.14 Secila Palë, gjatë gjithë kohës, mund të konsideron shkeljen e dispozitave të këtij neni nga pala pranuese si bazë për pezullimin urgjent të zbatimit të kësaj Marrëveshje dhe të kërkon për përfundimin automatik të të njejtës.

### Neni 13

#### SHKËMBIMI DHE MBROJTJA E INFORMACIONEVE TË FSHEHTA

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Palëve, Palët do të zbatojnë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen, transferimin dhe qasjen në informacione të përdoruesve në përputhje me legjislacionin kombëtar për informacionet e fshehta (të klasifikuara) dhe mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me këtë Marrëveshje.

13.1 Palët do të vendosin të njëjtin nivel të mbrojtjes për informacionet e fshehta sipas klasifikimit të informacionit nga ana e dërguesit me të njëjtin nivel të vlerësimit të sigurisë.

13.2 Në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës kombëtar, Palët do të implementojnë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e Informacioneve të Fshehta të referuara në këtë Marrëveshje. Palët do t'ua mundësojnë Informacioneve të tilla të Fshehta të njëjtin nivel të mbrojtjes ashtu si sigurohen Informacionet kombëtare të Fshehta me nivelin e klasifikimit të sigurisë që korrespondon.

13.3 Qasja në Informacione të Fshehta do të kufizohet në individët të cilët Duhet-ta-Dinë (Need-to-know) dhe të cilët kanë, në përputhje me legjislacionin kombëtar, certifikatën e lejes hyrëse të personelit të sigurimit (security clearance), autorizim për qasje në Informacionet e tilla të Fshehta.

13.4 Informacionet e fshehta do të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat ato janë transferuar.

13.5 Pala pranuese nuk do të shpërndan informacionet e fshehta Palëve të treta pa marr pëlqimin me shkrim paraprakisht nga Pala e origjinës, dhe si theksohet në Nenin 12, pika 12.11.

### Neni 14

## RELACIONI NDAJ MARRËVESHJEVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Kjo Marrëveshje nuk do të cenon të drejtat dhe obligimet e Palëve, sipas cilësdo Marrëveshje tjetër ndërkombëtare në të cilën Palët janë aktualisht ose mund të bëhen palë në të në të ardhmen.

### Neni 15

#### ZGJIDHJA E KONFLIKTIT

Të gjitha dallimet që dalin nga interpretimi ose aplikimi i dispozitave të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet nga Komisioni. Çështjet, për të cilat Komisioni nuk bie dakord, do të zgjidhen përmes kanaleve diplomatike.

### Neni 16

#### E DREJTA PËR REFUZIM

Secila Palë mund të refuzon përkohësisht, plotësisht ose pjesërisht, bashkëpunimin ose asistencën, në qoftë se Pala përkatëse konsideron të jetë e dëmshme për sigurinë kombëtare ose interesat e Palës ose në qoftë se është në kundërshtim me legjislacionin e saj kombëtar. Pala tjetër do të informohet menjëherë me shkrim në lidhje me bazat (arsyet) e refuzimit të tillë.

### Neni 17

#### SHPENZIMET

Secila Palë do të mbulon shpenzimet e tyre të ndërlidhura dhe përkatëse që dalin nga implementimin i kësaj Marrëveshje. Shpenzimet që dalin në përputhje me dispozitat e Nenit 8, pika 8.3 të kësaj Marrëveshje do të jenë një përjashtim.

### Neni 18

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kjo Marrëveshje do të hyj në fuqi 30 ditë nga pranimi i njohimit të fundit me anë të së cilës Palët informojnë njëra tjetrën mbi përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet ose plotësohet me pëlqimin me shkrim të dyanshëm të Palëve. Ndryshimet dhe plotësimet e dakorduara do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e njëjtë të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

Kjo Marrëveshje mund të prishet nga cilado Palë. Në rast të prishjes, kjo Marrëveshje do të pushon të jetë valide 30 ditë pas datës kur njoftimi me shkrim nga njëra Palë është pranuar nga Pala tjetër përmes kanaleve diplomatike.

Kjo Marrëveshje është arritur për një periudhë pesë (5) vjeçare) dhe në mënyrë automatike do të ripërtërin validitetin e saj për periudhën e ardhshme pesë (5) vjeçare përveç nëse njëra prej Palëve njofton me shkrim Palën tjetër për synimet e saj për prishjen e Marrëveshjes dhe si theksohet këtu.


Me qëllim të kushteve dhe të bashkëpunimit të kësaj Marrëveshje, dhe ashtu si aplikohet, kopja e origjinalit të nënshkruar do të shërben si të ishte origjinal.

E nënshkruar më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ në dy (2) kopje identike, secila prej tyre në gjuhën maqedone, shqipe, serbe dhe angleze; duke qenë të gjitha tekstet e vlefshme barabartë.

Në rast të dallimeve në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje, versioni anglisht do të mbizotëron.

Regjistrimi i kësaj Marrëveshje në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në përputhje me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara mund të inicohet nga njëra Palë Kontraktuese me hyrjen në fuqi të saj. Pala tjetër Kontraktuese do të njoftohet për regjistrimin e bërë duke iu referuar numrit të regjistrimit të KB-ës të dhënë, sa më parë që ky numër të konfirmohet nga Sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

Për Republikën e Maqedonisë:



Për Republikën e Kosovës:

